

<p><i>Acquis</i> së BE-sëqë synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare) CELEX : 02000L0060-20141120 DIREKTIVA 2000/60/KE E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE E KËSHILLIT e datës 23 Tetor 2000 “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave (OJ L 327, 22.12.2000, p. 1–73)</p>		<p>Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) Projekt Ligj “Për Burimet Ujore” Shkalla e përafrimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur Shkalla e Përafrimit e pjesshme</p>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të <i>acquis</i> së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit.	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.	Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës	Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projektaktit	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafrohet kërkesat e nenit të <i>acquis</i> së BE-së në kolonën e dytë.	Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafrimit për çdo nen të veçantë.	Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafrimit. Kur përafrimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafrimi i plotë.
Neni.1, paragrafi i parë	Qëllimi i kësaj Direktive është ngritja e një kuadri ligjor për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësorë të brendshëm, ujërave të përkohshëm, ujërave bregdetarë dhe ujërave nëntokësorë dhe e cila:		Neni 2, paragrafi i parë	Objekti i këtij ligji është përcaktimi i kuadrit ligjor dhe institucional për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore, me synim:	E plotë	

Neni 1, germa (a)	a)Parandalon përkeqësimin e mëtejshëm, ruan dhe forcon gjendjen e sistemeve ujore, në lidhje me nevojën e tyre për ujë, ekosistemet tokësore dhe kënetat drejtpërdrejt të varura nga ekosistemet ujore;		Neni 2, germa (a)	a) mbrojtjen, përmirësimin dhe parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të statusit të ekosistemeve ujore lidhur me nevojat e tyre për ujë, ekosistemeve tokësore dhe ligatinave që janë në varësi të drejtpërdrejtë nga këto ekosisteme;	E plotë	
Neni 1, germa (b)	b)Promovon përdorimin e vazhdueshëm të ujit, bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore të disponueshme;		Neni 2, germa (b)	b) promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore të disponueshme;	E plotë	
Neni 1, germa (c)	c)Ka për qëllim forcimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit ujor, përveç të tjerash nëpërmjet masave specifike për një reduktim progresiv të shkarkimeve, derdhjes dhe humbjeve të substancave parësore dhe ndalimin ose menjanimin e ngadaltë të shkarkimeve, lëshimeve dhe humbjeve të substancave të rrezikshme parësore;		Neni 2, germa (c)	c) përforcimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit ujor, ndër të tjera, përmes zbatimit të masave të veçanta për: i) uljen progresive të shkarkimeve, emetimeve dhe humbjeve të substancave prioritare, ndërprerjen ose uljen graduale të shkarkimeve, emetimeve dhe humbjeve të substancave prioritare të rrezikshme nga burimet dhe veprimtaritë industriale;	E plotë	
Neni 1, germa (d)	d)Siguron një reduktim progresiv të ndotjes së ujërave nëntokësorë dhe parandalon ndotjen e mëtejshme të tyre, si dhe		Neni 2, germa (ç)	ç) uljen progresive të ndotjes së ujërave nëntokësorë dhe parandalimin e ndotjes së mëtejshme të tyre;	E plotë	
Neni 1, germa (e)	e)Kontribuon në zvogëlimin e pasojave të përmytjeve dhe të thatësirave, ndaj kontribuon në: -Sigurimin e sasisë së mjaftueshme të ujërave		Neni 2, germa (d)	d) zbutjen e efekteve të përmytjeve dhe thatësirave duke kontribuar në:	E plotë	

	<p>sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të një cilësie të mirë, ashtu siç nevojitet për një përdorim të qëndrueshëm, të baraspeshuar dhe të barabartë të ujit,- Një reduktim të qenësishëm të ndotjes së ujërave nëntokësorë</p> <p>- Mbrojtjen e ujërave territoriale dhe detare, si dhe</p> <p>-Në arritjen e objektivave të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare, ku përfshihen edhe ato që synojnë parandalimin dhe zhdukjen e ndotjes së mjedisit detar, nëpërmjet ndërhyrjes së Komunitetit Evropian bazuar në Nenin 16 (3) për të ndaluar ose mënjanuar gradualisht shkarkimet, derdhjet dhe humbjet e substancave parësore të rrezikshme, me qëllimin përfundimtar të arritjes së përqendrimeve në mjedisin detar afër normave bazë për substancat me origjinë natyrore dhe çuarjen në zero të substancave sintetike të prodhuara nga njeriu.</p>			<p>i) sigurimin e furnizimit të mjaftueshëm me ujëra sipërfaqësorë dhe ujëra nëntokësorë të cilësisë së mirë, sipas nevojave për përdorimin e qëndrueshëm, të ekuilibruar dhe të drejtë të ujit;</p> <p>ii) uljen e ndjeshme të ndotjes së ujërave nëntokësorë;</p> <p>iii) mbrojtjen e ujërave territoriale dhe detare; dhe</p> <p>iv) përmbushjen e objektivave të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare, përfshi ato që synojnë parandalimin dhe eliminimin e ndotjes së mjedisit detar, përmes veprimeve për të ndaluar ose pakësuar gradualisht deri në zero shkarkimet, emetimet dhe humbjet e substancave prioritare, duke pasur si qëllim përfundimtar arritjen e përqendrimeve në mjedisin detar afër vlerave bazë për substancat natyrore dhe afër zeros për substancat sintetike të krijuara nga njeriu;</p>		
Neni. 2, pika 11	<p>11. “Akuifer” do të thotë një shtresë nënsipërfaqësore, shtresa të një shkëmbi ose shtresa të tjera gjeologjike të një poroziteti të mjaftueshëm dhe një depërtueshmërie për të lejuar një rrjedhje të</p>		Neni 3, pika 2	<p>2. “Akuifer” është një apo disa shtresa nënsipërfaqësore të shkëmbinjve a formacioneve të tjera gjeologjike të tokës, me porozitet dhe përshkueshmëri të mjaftueshme, që mundësojnë</p>	E plotë	

	konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose shkëputjen e sasive të konsiderueshme të tyre.			rrjedhje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose nxjerrjen e sasive të konsiderueshme të ujërave nëntokësore.		
Neni 2, pika 16	16. 'Autoriteti kompetent' do të thotë një autoritet ose autoritetet e identifikuar sipas nenit 3(2) ose 3(3).		Neni 3, pika 3	3. “Autoriteti kompetent” është autoriteti apo autoritetet e përcaktuara sipas nenit 14 të këtij ligji për zbatimin e dispozitave të këtij ligji në çdo rajon të basenit lumor në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 13 të këtij ligji;	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 2, pika 16 e Direktivës, (neni 3(2)), është transpozuar plotësisht nga referenca e vendosur në neni 3, pika 3 e Projektligjit (neni 13)
Neni 2, pika 13	13. 'Pellg ujor' do të thotë sipërfaqja e tokës nga e cila e gjithë sipërfaqja derdhëse rrjedh përmes një sekuence të rrymave, lumenjve dhe, mundësisht, liqeneve për në det sipas një grykderdhje të vetme, grykderdhje të gjerë ose delte.		Neni 3, pika 7	7. “Basen lumor” është sipërfaqja e tokës prej ku, përmes një sërë përrenjsh, lumenjsh apo edhe liqenesh, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në det, në një grykëderdhje të vetme, estuar apo deltë.	E plotë	
Neni 2, pika 27	27. 'Burime të vlefshme ujore' do të thotë që norma mesatare vjetore afatgjatë e rimbushjes së plotë të një mase të ujërave nëntokësore është më pak se norma vjetore afatgjatë e rrjedhjes së kërkuar për të arritur objektivat ekologjike të cilësisë për ujrën e sipërfaqeve mbledhëse specifikuar në Nenin 4, për të shmangur ndonjë pakësim të konsiderueshëm në gjendjen ekologjike të ujërave të tilla dhe për të shmangur ndonjë dëmtim të konsiderueshëm të		Neni 3, pika 9	9. “Burime të disponueshme të ujërave nëntokësore” është shkalla mesatare vjetore afatgjatë e ripërtëritjes së një trupi ujor nëntokësor pa normën vjetore afatgjatë të rrjedhës së nevojshme për përmbushjen e objektivave të cilësisë mjedisore për ujërat sipërfaqësore përkatëse, sipas këtij ligji, me qëllim shmangien e uljes së konsiderueshme të statusit ekologjik të këtyre ujërave dhe me qëllim shmangien e dëmtimit të	E plotë	

	ekosistemeve tokësore të bashkuara.			konsiderueshëm të ekosistemeve tokësore të lidhura me to.		
Neni 2, pika 41	41. 'Kontrollet e shkarkimit' janë kontrollet që kërkojnë një kufi specifik të shkarkimit, për shembull një vleftë kufi të shkarkimit, ose ndryshe specifikimin e kufijve ose kushteve për efektet, natyrën ose karakteristika të tjera të një emisioni ose kushtet vepruese të cilat ndikojnë shkarkimet. Përdorimi i termit 'shkarkim' në këtë Direktivë sipas dispozitave të ndonjë Direktive tjetër nuk duhet të kuptohet si një riinterpretim të dispozitave të tyre në ndonjë formë.		Neni 3, pika 25	25. “Kontrollet e emetimeve” janë kontrollet që kërkojnë një kufizim specifik të emetimit, për shembull një vlerë kufi të emetimit ose përndryshe përcaktimin e kufijve apo kushteve lidhur me efektet, llojin apo karakteristika të tjera të një emetimi ose kushtet operationale të cilat ndikojnë në emetime.	E plotë	
Neni 2, pika 5	5. 'Liqen' do të thotë një masë e ujërave sipërfaqësore të brendshme të ndenjura.		Neni 3, pika 30	30. “Liqen” është një trup me ujëra të brendshme sipërfaqësore dhe nëntokësore të qëndrueshme.	E plotë	
Neni 2, pika 4	4. 'Lumë' do të thotë një masë e ujërave të brëndshme rrjedhëse, në pjesën më të madhe mbi sipërfaqen e truallit, por mund të rrjedhë dhe në pjesën nëntokësore të shtresës së tij.		Neni 3, pika 32	32. “Lum” është një trup ujqor i brendshëm, me ujë, që në pjesën më të madhe të tij rrjedh mbi sipërfaqen e tokës, por që në një pjesë të rrjedhës së tij mund të rrjedhë edhe nën tokë.	E plotë	
Neni 2, pika 31	31. 'Ndotës' quhet çdo substancë e rrezikshme që shkakton ndotje, të renditura në veçanti në Shtojcën VIII.		Neni 3, pika 37	37. “Ndotës” është çdo substancë e rrezikshme që shkakton ndotje, në veçanti ato të	E plotë	

				përcaktuara në zbatim të nenit 80 të këtij ligji.		
Neni 2, pika 33	33. ' Ndotje' do të thotë futje drejtpërdrejt ose tërthoras, si rezultat i nje aktiviteti njerëzor, i substancave ose nxehtësisë në ajër, ujë ose tokë e cila mund të jetë e dëmshme për shëndetin njerëzor ose cilësinë e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore që varen direkt nga sistemet ujore, të cilat rezultojnë në dëmtimin e pasurisë materiale, ose të cilët përkeqësojnë ose pengojnë me mjete dhe të tjerë që ligjërojnë shfrytëzimin e mjedisit.		Neni 3, pika 38	38. “Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, si rezultat i aktivitetit njerëzor, e substancave ose nxehtësisë në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut ose cilësinë e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore që varen drejtpërsëdrejti nga ekosistemet ujore, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin për mjedisin.	E plotë	
Neni 2, pika 14	14. 'Nënpellg' do të thotë sipërfaqja e tokës nga e cila gjithë ajo derdhëse rrjedh përmes një serie rrymash, lumenjsh dhe, mundësisht liqenesh tek një pikë e veçantë në një shtresë uji(normalisht një liqen ose një bashkërrjedhje lumore).		Neni 3, pika 39	39. “Nënbasen” është sipërfaqja e tokës nga e cila rrjedhin të gjitha prurjet sipërfaqësore të përrrenjve, lumenjve dhe dhe kur është e mundur të liqeneve në një pikë të caktuar të një rrjedhe uji, zakonisht një liqen ose një bashkim lumenjsh.	E plotë	

Neni 2, pika 35	35. 'Standarde të cilësisë mjedisore' do të thotë përqëndrimi i ndotësve të veçantë ose i grupit të ndotësve në ujë, sedimente ose biota e cila nuk duhet të tejkalohet me qëllim që të mbrojmë shëndetin njerëzor dhe mjedisin.		Neni 3, pika 42	42. “Norma e cilësisë mjedisore” është përqëndrimi i një substance ndotëse të veçantë ose i një grupi substancash ndotëse në ujë, në sedimente ose në biotë, i cili nuk duhet të tejkalohet me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit.		
Neni 2, pika 34	34. 'Objektiva mjedisore' do të thotë objektivat e vendosura në Nenin 4.		Neni 3, pika 45	45. “Objektivat mjedisore” janë objektivat e përcaktuar në nenet 20, 21 dhe 56 të këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 2 pika 34 e Direktivës është transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 20 pika 1 dhe nenet 21 22 23 24 25 26 të porojektligjit)
Neni 2, pika 39	39. ' Përdorimi i ujit' do të thotë shërbimet e ujit së bashku me ndonjë aktivitet tjetër identifikuar sipas Nenit 5 dhe Shtojcës II duke pasur një impakt të rëndësishëm mbi statusin e ujit.		Neni 3, pika 48	48. “Përdorimi i ujit” janë shërbimet si dhe çdo veprimtari tjetër e identifikuar në nenin 28 të këtij ligji, që ka ndikim të rëndësishëm në statusin e ujit. Ky përkufizim zbatohet për qëllimet e këtij ligji sipas përcaktimeve të nenit 2 dhe analizës ekonomike të kryer në përputhje me nenin 28 të këtij ligji.	E plotë	Neni 5 i Direktivës është transpozuar nga nenet 27-28 të projektligjit.
Neni 2, pika 23	23. ' Potencial ekologjik i mirë' është gjendja e një mase ujore artificiale ose tejet të modifikuar, klasifikuar të tilla në përputhje me dispozitat përkatëse të Shtojcës V.		Neni 3, pika 55	55. “Potencial i mirë ekologjik” është statusi i një trupi ujqor tepër të modifikuar ose i një trupi ujqor artificial, kur ai	E plotë	

				klasifikohet si i tillë sipas nenit 41, pika 5 e këtij ligji.		
Neni 2, pika 36	36. 'Trajtim i kombinuar' do të thotë kontroll i shkarkimeve dhe i derdhjeve në ujërat sipërfaqësore, sipas trajtimit të vendosur në Nenin 10.		Neni 3, pika 59	59. “Qasja e kombinuar” është kontrolli i shkarkimeve dhe emetimeve në ujërat sipërfaqësore, sipas mënyrës së trajtimit të përcaktuar në nenin 43 të këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 2, pika 36 (neni 10), është përafshuar plotësisht nga referenca e vendosur në nenin 3, pika 61 (neni 43)
Neni 2, pika 15	15. 'Rajon baseni ujëmbledhës' do të thotë zona e tokës dhe deti, krijuar prej një ose më shumë basene ujëmbledhës të lumenjve fqinjë së bashku me ujërat mbledhës nëntokësorë dhe ujërat bregdetarë, i cili është identifikuar sipas nenit 3(1) si njësisia kryesore për menaxhimin e baseneve ujëmbledhës.		Neni 3, pika 60	60. “Rajon i basenit lumor” është sipërfaqja e tokës dhe detit e përbërë nga një ose më shumë basene lumorë fqinjë, së bashku me ujërat e tyre përkatëse nëntokësorë dhe bregdetarë, që identifikohen dhe i caktohen atij rajoni (individual) të basenit lumor.	E plotë	Neni 3, pika 1 e Direktivës është transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit. (neni 12 i projektligjit)
Neni 2, pika 21	21. ' Gjendja ekologjike' është një shprehje e cilësisë së një strukture dhe funksionimit të ekosistemit ujqor shoqëruar me ujërat sipërfaqësore, klasifikuar në përputhje me Shtojcën V.		Neni 3, pika 70	70. “Status ekologjik” është shprehja e cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujore, që lidhen me ujërat sipërfaqësore, të klasifikuar në zbatim të nenit 41, pika 5 e këtij ligji.	E plotë	Shtojca V është transpozuar nga neni 175 projektligjit.
Neni 2, pika 22	22. ' Gjendja ekologjike e mirë' është gjendja e një mase të një sipërfaqe ujore, klasifikuar në përputhje me Shtojcën V.		Neni 3, pika 71	71. “Statusi i mirë ekologjik” është statusi i një trupi ujqor sipërfaqësor, i klasifikuar në	E plotë	

				zbatim të nenit 41, pika 2 e këtij ligji.		
Neni 2, pika 25	25. ' Gjendja kimike e mirë e ujërave nëntokësore' është gjendja e një mase të ujërave nëntokësore, e cila plotëson të gjitha kushtet e vendosura në tabelën 2.3.2 të Shtojcës V.		Neni 3, pika 72	72. “Status i mirë kimik i ujërave nëntokësore” është statusi kimik i një trupi ujqor nëntokësor, që përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në zbatim të neneve 59, 60, 61, 62, 63, të këtij ligji.	E Plotë	
Neni 2, pika 24	24. ‘ Gjendja kimike e mirë e ujërave sipërfaqësore ‘ do të thotë gjendja kimike e nevojshme për të plotësuar objektivat mjedisore për ujërat sipërfaqësore vendosur në Nenin 4(1)(a), që është gjendja kimike e arritur me anë të një mase uji sipërfaqësor në të cilën përqëndrimi i ndotësve nuk tejkalon standardet e cilesise mjedisore të vendosur në Shtojcën IX dhe Nenin 16(7), dhe sipas legjislacioneve të tjera përkatëse duke vendosur standardet e cilesisë mjedisore në nivel komuniteti.		Neni 3, pika 73	73. “Status i mirë kimik i ujërave sipërfaqësore” është statusi kimik i nevojshëm për përmbushjen e objektivave mjedisore për ujërat sipërfaqësore sipas përcaktimeve në nenin 20 të këtij ligji, që është statusi kimik i arritur nga trupi ujqor sipërfaqësor në të cilin përqëndrimet e ndotësve nuk tejkalojnë standardet cilësore mjedisore të përcaktuara në zbatim të nenit 67, pika 2 e këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 2, pika 24 (neni 4 (1) (a)) është përafëruar nga referenca e vendosur në nenin 3, pika 37 (neni 20)
Neni 2, pika 20	20. 'Gjendja e mirë e ujërave nëntokësore ' do të thotë gjendje e arritur me anë të një mase ujërash nënujqore, kur të dyja, si gjendja e tij ekologjike dhe kimike, janë të paktën 'mirë'.		Neni 3, pika 74	74. “Status i mirë i ujërave nëntokësore” është statusi i arritur nga një trup me ujëra nëntokësore, kur si statusi i tij sasior, ashtu edhe statusi i tij kimik vlerësohen të paktën po aq “të mirë” sa	E plotë	

				përcaktimet e akteve ligjore në fuqi.		
Neni 2, pika 18	18. 'Gjendje optimale e ujërave sipërfaqësore' do të thotë gjendje optimale e arritur në një mase ujore sipërfaqësore kur të dyja, si gjendja ekologjike dhe kimike janë të paktën 'mirë'		Neni 3, pika 75	75. “Status i mirë i ujërave sipërfaqësore” është gjendja e arritur nga një trup ujour sipërfaqësor, ku si gjendja e tij ekologjike, ashtu edhe gjendja e tij kimike janë vlerësuar të paktën po aq “të mira”, sa përcaktimet në aktet ligjore në fuqi.	E plotë	
Neni 2, pika 28	28. 'Gjendje e mirë sasiorë' është gjendja e përkufizuar në tabelën 2.1.2 të Shtojcës V.		Neni 3, pika 76	76. “Status i mirë sasior i ujërave nëntokësorë” është statusi sasior i një trupi ujour nëntokësor, i përcaktuar në zbatim të neneve 59, 60, 61, 62, 63 të këtij ligji.	E plotë	
Neni 2, pika 19	19. 'Gjendja e ujërave nëntokësorë' është një shprehje e përgjithshme e gjendjes së një mase të ujërave nëntokësorë, përcaktuar me anë të nivelit minimal sasior dhe statusit kimik.		Neni 3, pika 77	77. “Status i ujërave nëntokësorë” është shprehja në mënyrë të përgjithshme e statusit të një trupi ujour nëntokësor, që përcaktohet nga statusi i tij më i ulët sasior dhe kimik.	E plotë	
Neni 2, pika 17	17. 'Gjendja e ujërave sipërfaqësore' është një shprehje e përgjithshme e gjendjes së një mase të ujërave sipërfaqësore, përcaktuar me anë të gjendjes së tij më të varfër ekologjike dhe kimike.		Neni 3, pika 78	78. “Status i ujërave sipërfaqësore” është shprehja e përgjithshme e gjendjes së një trupi ujour sipërfaqësor, që përcaktohet nga gjendja e tij	E plotë	

				ekologjike, cilësore dhe kimike më e ulët.		
Neni 2, pika 26	26. 'Gjendja sasiore' është një shprehje e shkallës në të cilën një masë e ujërave nëntokësore është e ndikuar nga shkëputjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta.		Neni 3, pika 79	79. “Status sasiore” është shprehja e masës, në të cilën një trup ujor nëntokësor ndikohet nga shfrytëzimi i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë.	E plotë	
Neni 2, pika 30	30. 'Substanca prioritare' do të thotë substanca të identifikuar në përputhje me Nenin 16(2) dhe të renditura në Shtojcën X. Midis këtyre substancave gjenden 'substancat e rrezikshme parësore' e cila do të thotë substancat e identifikuar në përputhje me Nenin 16(3) dhe (6) për të cilën masat duhet të merren në përputhje me Nenin 16(1) dhe (8).		Neni 3, pika 81	81. “Substanca prioritare” janë substancat e përcaktuara në zbatim të nenit 67, pika 2 të këtij ligji. Ndërmjet këtyre substancave janë përcaktuar “substancat prioritare të rrezikshme”, për të cilat duhet të merren masa në zbatim të parashikimeve të këtij neni.	E plotë	
Neni 2, pika 29	29. 'Substanca të rrezikshme' do të quhen substancat ose grupet e substancave që janë toksike, të përhershme dhe të rrezikshme të bio-akumulueshme, dhe substanca të tjera ose grup substancash të cilat rrisin shqetësimin deri në një nivel të barasvlefshëm.		Neni 3, pika 83	83. “Substancë e rrezikshme” është një substancë apo grup substancash që janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t'u grumbulluar biologjikisht, si dhe substanca apo grupe substancash, që rezultojnë në një nivel të barabartë grumbullimi.	E plotë	
Neni 2, pika 38, pika e parë	38. 'Shërbimet e ujit' do të thotë të gjitha shërbimet të cilat sigurojnë për ekonominë		Neni 3, pika 85, pika 1	85. “Shërbimet e ujit” janë të gjitha shërbimet që ofrojnë, për	E plotë	

	shtëpiake, institucionet publike ose ndonjë aktivitet ekonomik:			familjarë, institucione publike dhe çdo aktivitet ekonomik:		
Neni 2, pika 38, pika e parë, germa (a)	(a) shkëputje, mbledhje, grumbullim, trajtim dhe shpërndarje të sipërfaqes ujore dhe ujërave nëntokësore,		Neni 3, pika 85, pika 1 germa (a)	a) nxjerrje, grumbullim, depozitim, trajtim dhe shpërndarje të ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore;	E plotë	
Neni 2, pika 38, pika e parë, germa (b)	(b) mjetet e trajtimit dhe grumbullimi i ujërave të zeza që rrjedhimisht shkarkohen në ujërat sipërfaqësore.		Neni 3, pika 85, pika 1 germa (a)	b) impiante mbledhje dhe përpunimi të ujërave të ndotura, të cilat më pas shkarkohen në ujërat sipërfaqësore	E plotë	
Neni 2, pika 32	32. 'Shkarkim direkt tek ujërat nëntokësore' do të thotë shkarkim i ndotësve në drejtim të ujrave nëntokësore pa filtrim, nëpërmjet dheut dhe nënshtresave.		Neni 3, pika 86	86. "Shkarkim i drejtpërdrejtë në ujëra nëntokësore" është shkarkimi i ndotësve në ujërat nëntokësore pa u filtruar në të gjithë shtresat e tokës apo nëntokës.	E plotë	
Neni 2, pika 8	8. 'Masë ujore artificiale' do të thotë një masë uji sipërfaqësor e krijuar nga një aktivitet njerëzor.		Neni 3, pika 93	93. "Trup ujqor artificial" është trupi ujqor sipërfaqësor i krijuar nga aktiviteti njerëzor.	E plotë	
Neni 2, pika 12	12. 'Masë e ujërave nëntokësore' do të thotë një vëllim i qartë i ujërave nëntokësore brenda një horizonti ujëmbajtës ose horizonteve ujëmbajtëse		Neni 3, pika 94	94. "Trup ujqor nëntokësor" është ujë nëntokësor me vëllim të veçantë brenda një akuiferi ose akuifereve.	E plotë	
Neni 2, pika 10	10. 'Masë uji sipërfaqësor' do të thotë një element i veçantë dhe i rëndësishëm i ujit sipërfaqësor të		Neni 3, pika 95	95. "Trup ujqor sipërfaqësor" është një element i dallueshëm dhe	E plotë	

	tillë si një liqen, rezervuar, një rrymë, lumë ose kanal, pjesë të një rryme, lumë ose kanal, ujë i përkohshëm ose një shtrirje e ujërave bregdetare.			i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësorë, si një liqen, rezervuar, përrua, lum ose kanal, një pjesë e një përroi, lumi ose kanali, ujëra tranzitorë ose një segment i ujërave bregdetare.		
Neni 2, pika 9	9. 'Masë ujore tejet e modifikueshme' do të thotë një masë uji sipërfaqësor e cila si rezultat i ndryshimeve fizike prej aktiviteteve njerëzore ka ndryshuar në mënyre thelbësore në përmbajtje, siç është projektuar nga shtetet anëtare, në përputhje me dispozitat e Shtojcës II.		Neni 3, pika 96	96. “Trup ujqor tepër i modifikuar” është trupi ujqor sipërfaqësor, i cili si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor, ka ndryshuar rrënjësisht karakterin e tij, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës të autoritetit kompetent.	E plotë	
Neni 2, pika 37	37. 'Ujë i caktuar për konsum njerëzor' ka të njëjtin kuptim si në Direktivën 80/778/EEC, siç është ndrequr me Direktivën 98/83/EC.		Neni 3, pika 99	99. “Ujë i pijshëm” është uji i përcaktuar për konsum njerëzor, që përfshin sa më poshtë: a) ujërat e trajtuara ose të patrajtuara, të përcaktuara për qëllim pirjeje, gatimi, përgatitjeje të ushqimeve dhe për nevojat e higjienës, pavarësisht nga origjina e tyre dhe nga fakti nëse janë furnizuar prej një rrjeti shpërndarës, publik apo privat, prej depozitave, prej autoboteve, prej puseve, individuale apo kolektive, apo të ambalazuara në shishe ose enë;	E plotë	Përkufizimi në projektligj është në përputhje me kuptimin e dhënë nga Direktiva 98/83/EC.

				<p>b) ujërat që përdoren në ndërmarrjet e prodhimit të ushqimeve për prodhimin, fabrikimin, përpunimin, ruajtjen apo tregtimin e prodhimeve ose lëndëve të përcaktuara për përdorim nga njerëzit, si dhe ujërat për pastrimin e sipërfaqeve, objekteve apo materialeve që mund të jenë në kontakt me artikuj ushqimorë;</p> <p>c) akujt ushqimorë me origjinë ujore;</p> <p>ç) ujërat e furnizuara për përdorim nga njerëzit, si pjesë e një aktiviteti tregtar apo publik, pavarësisht nga sasia mesatare e ujit të furnizuar në ditë.</p>		
Neni 2, pika 7	7. 'Ujëra bregdetare' do të thotë sipërfaqe ujore mbi vijën bregdetare të tokës, çdo pikë e së cilës ndodhet një milje detare larg prej vijës bregdetare nga pika më e afërt e vijës bazë, nga e cila është matur gjërësia e ujërave territoriale, duke u shtrirë në mënyrë të përshtatshme deri në kufirin e jashtëm të ujërave të përkohshme.		Neni 3, pika 100	100. “Ujëra bregdetare” janë ujërat sipërfaqësorë, të cilat ndodhen në brendësi të një vije imagjinare, e cila është e barazlartuar në secilën nga pikat e saj 1 milje detare nga pjesa e jashtme e pikës më të afërt të vijës bazë dhe që shërben si referim për të përcaktuar shtrirjen e ujërave territoriale dhe që shtrihen rrjedhimisht deri në kufirin e	E plotë	

				jashtëm të ujërave tranzitore. Për qëllimet e zbatimit të neneve 96 - 110 të këtij ligji, termi “ujëra bregdetare” ka kuptimin e ujërave jashtë vijës së ulët të ujit apo kufirit të jashtëm të një estuari.		
Neni 2, pika 3	3. 'Ujëra të brendshme' do të thotë të gjitha ujërat e ndenjura ose ujërat e rrjedhshme mbi sipërfaqen e një terreni, dhe gjithë ujrat nëntokësore në drejtim të themelit të tokës mbi të cilën është matur gjerësia territoriale e tyre.		Neni 3, pika 102	102. “Ujëra të brendshme” janë të gjitha ujërat e ndenjura ose ujërat e rrjedhshme mbi sipërfaqen e një terreni dhe të gjitha ujërat nëntokësore në drejtim të bazamentit të tokës, mbi të cilën është matur gjerësia territoriale e ujërave.	E plotë	
Neni 2, pika 2	2. 'Ujëra nëntokësore' do të thotë i gjithë uji i cili është nën sipërfaqen e tokës në zonën ujëmbajtëse dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me tokën ose tabanin.		Neni 3, pika 104	104. “Ujëra nëntokësore” janë të gjitha ujërat që ndodhen nën sipërfaqen e tokës në zonën e ngopjes dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me terrenin dhe nëntokën.	E plotë	
Neni 2, pika 1	1.'Ujëra sipërfaqësore' janë ujëra të brendshme, përveç ujit nëntokësor; ujëra të përkohshme dhe uëjra bregdetare, me përjashtim të statusit kimik për të cilin ai duhet të përfshijë gjithashtu ujërat territoriale.		Neni 3, pika 108	108. “Ujëra sipërfaqësore” janë ujërat e brendshme, me përjashtim të ujërave nëntokësore, ujërave të përkohshme dhe ujërave bregdetare, përveç rasteve kur statusi kimik përkatës mund të përfshijë dhe ujërat territoriale.	E plotë	

Neni 2, pika 6	6. 'Ujëra të përkohshme' janë masat e sipërfaqes ujore në rrethinat e grykëderdhjeve të cilat janë pjesërisht të kripura natyrshëm, si rrjedhojë e afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por të cilat janë ndikuar kryesisht nga rrjedhjet e ujërave të ëmbla.		Neni 3, pika 110	110. “Ujëra tranzitore” janë trupat ujorë sipërfaqësorë në afërsi të grykëderdhjeve të lumenjve, që janë pjesërisht me karakter të kripur si rezultat i afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por që kryesisht ndikohen nga rrjedha me ujëra të ëmbla.	E plotë	
Neni 2, pika 40	40. 'Vlefata kufitare e shkarkimit' do të thotë masa, e shprehur në termat e parametrave specifikë të sigurtë, përqëndrimi dhe/ose niveli i shkarkimit, i cili mund të mos tejkalohet gjatë një ose më shumë periudhave kohore. Vlefata kufitare e shkarkimit mund të përgatitet gjithashtu për një grup të caktuar, familje ose kategori substancash, dhe në veçanti për ato të identifikuara në Nenin 16. Vlerat e lejueshme të shkarkimit të substancave duhet të zbatohen normalisht deri në çastin kur kryhet shkarkesa, duke e bërë tretësirën të papërfillshme me vendosjen e tyre. Në lidhje me shkarkimet jo të drejtpërdrejta në ujë, impianti i trajtimit të ujërave të zeza mund të merret në konsideratë kur përcaktohen vlerat e lejueshme të shkarkimit të instalimeve të		Neni 3, pika 113	113. “Vlera kufi e emetimit” është masa, e shprehur në termat e parametrave specifikë të sigurt, përqëndrimit ose nivelit të emetimit, që nuk duhet të tejkalohet gjatë një ose më shumë periudhave kohore. Vlerat kufi të emetimit mund të përcaktohen edhe për grupe, familje apo kategori të caktuara substancash të renditura në vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 80, pika 3 e këtij ligji. Vlerat kufi të emetimit për substancat zbatohen zakonisht në pikën ku emetimet dalin nga instalimi, duke mos marrë parasysh hollimin për përcaktimin e tyre. Në lidhje me lëshimin e tërthortë në ujë, efekti i një impianti për trajtimin e ujërave të	E plotë	

	<p>përfshira, duke siguruar që është garantuar një nivel ekuivalent për mbrojtjen e ambientit si një e tërë dhe duke siguruar që kjo nuk shpie në nivele të larta të ndotjes së ambientit.</p>			<p>ndotura mund të merret parasysh gjatë përcaktimit të vlerave kufi të emetimit të instalimeve të përfshira me kusht që të garantohet një nivel ekuivalent për mbrojtjen e mjedisit në tërësi dhe me kusht që kjo të mos çojë në nivele më të larta të ndotjes në mjedis.</p>		
<p>Neni 3, pika 1</p>	<p>1. Shtetet anëtare duhet të identifikojnë shtrirjen e veçantë të baseneve ujëmbledhës brenda territorit kombëtar të një vendi dhe, për qëllimet e kësaj Direktive, t'i përcaktojnë ato sipas rajoneve të veçanta të baseneve ujëmbledhës. Basenet ujëmbledhës mund të kombinohen me basene ujëmbledhës të mëdhenj ose të lidhen me basene ujëmbledhës të vogla fqinje për të krijuar basebe ujëmbledhës të veçanta aty ku është e përshtatshme. Aty ku ujërat nëntokësore nuk ndjekin plotësisht një basen ujëmbledhës të veçantë, ato duhet të identifikohen dhe transferohen për tek rajoni më i afërt dhe i përshtatshëm i basenit ujëmbledhës. Ujërat bregdetare duhet të identifikohen dhe transferohen për tek rajoni ose rajonet ujore</p>		<p>Neni 12</p>	<p>1. Territori i Shqipërisë ka këto basene kryesore lumore:</p> <p>a) Baseni Lumor Drin-Bunë;</p> <p>b) Baseni Lumor Vjosë;</p> <p>c) Baseni Lumor Erzen;</p> <p>ç) Baseni Lumor Shkumbin;</p> <p>d) Baseni Lumor Seman;</p> <p>dh) Baseni Lumor Mat;</p> <p>e) Baseni Lumor Ishëm.</p> <p>2. Baseni Lumor Drin- Bunë dhe Baseni Lumor Vjosë janë pjesë e baseneve lumore ndërkuftare:</p> <p>a) Baseni Lumor Ndërkuftar Drin - Bunë;</p> <p>b) Baseni Lumor Ndërkuftar Vjosë.</p>	<p>E plotë</p>	

	më të afërta ose të përshtatshme të lumit.			<p>3.Në basenin lumor Drin-Bunë ndodhen këto pjesë të baseneve apo nënbaseneve liqenore ndërkufitare:</p> <p>a)Baseni Liqenor Ndërkufitar Shkodër;</p> <p>b)Baseni Liqenor Ndërkufitar Ohri;</p> <p>c)Baseni Liqenor Ndërkufitar Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe.</p>		
Neni 3, pika 1	<p>1. Shtetet anëtare duhet të identifikojnë shtrirjen e veçantë të baseneve ujëmbledhës brenda territorit kombëtar të një vendi dhe, për qëllimet e kësaj Direktive, t'i përcaktojnë ato sipas rajoneve të veçanta të baseneve ujëmbledhës. Basenet ujëmbledhës mund të kombinohen me basene ujëmbledhës të mëdhenj ose të lidhen me basene ujëmbledhës të vogla fqinje për të krijuar basebe ujëmbledhës të veçanta aty ku është e përshtatshme. Aty ku ujërat nëntokësore nuk ndjekin plotësisht një basen ujëmbledhës të veçantë, ato duhet të identifikohen dhe transferohen për tek rajoni më i afërt dhe i përshtatshëm i basenit</p>		Neni 13	<p>1. Për qëllimet e këtij ligji, ngrihen rajonet e baseneve lumore ose liqenore, në të cilat rrjedhin ujërat e baseneve kryesore lumore dhe liqenore të renditura në nenin 12 të këtij ligji.</p> <p>2. Përveç baseneve kryesore lumore dhe liqenore të renditura në nenin 12 të këtij ligji, në rajonet e baseneve lumore do të caktohen edhe:</p> <p>a) basenet e vogla lumore;</p> <p>b) trupat e tjerë ujorë sipërfaqësorë;</p> <p>c) ujërat nëntokësorë;</p>	E plotë	

	ujëmbledhës. Ujërat bregdetare duhet të identifikohen dhe transferohen për tek rajoni ose rajonet ujore më të afërta ose të përshtatshme të lumit.			<p>c) ujërat bregdetare, që ndodhen në territorin e rajonit të basenit lumor më të afërt.</p> <p>Kur ujërat nëntokësorë i përkasin dy a më shumë baseneve lumore ato identifikohen dhe caktohen në rajonin më të afërt ose më të përshtatshëm të basenit lumor.</p> <p>Ujërat bregdetarë identifikohen dhe caktohen në rajonin më të afërt ose më të përshtatshëm të basenit lumor.</p> <p>Kufiri i jashtëm (detar) i estuarëve përcaktohet me qëllim zbatimin e masave të duhura në përputhje me këtë ligj.</p> <p>3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, përcakton përbërjen dhe kufijtë e rajoneve të baseneve lumore dhe trupave të tjerë ujorë sipërfaqësorë, ujërave nëntokësorë dhe ujërave bregdetare në rajonet individuale të baseneve lumore, në përputhje me këtë nen, jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p>		
Neni 3, pika 2	2. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë masat e përshtatshme,		Neni 14	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është autoriteti	E plotë	

	<p>duke përfshirë identifikimin e Autoritetit Kompetent të përshtatshëm, për zbatimin e rregullave të kësaj Direktive brenda çdo rajoni të basenit ujëmbledhës, të shtrirë brenda territorit të tyre.</p>			<p>kompetent për zbatimin e këtij ligji brenda secilit rajon të basenit lumor, në bashkëpunim me organet e tjera qendrore dhe vendore të parashikuara në këtë ligj.</p> <p>2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është autoriteti kompetent për zbatimin e këtij ligji brenda pjesëve të rajoneve ndërkombëtare të baseneve lumore dhe liqenore që ndodhen brenda territorit të Shqipërisë, në bashkëpunim me organet e tjera qendrore dhe vendore, të përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përcakton të gjithë elementet e informacionit për secilin autoritet kompetent në rajonet e baseneve lumore të krijuara në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, të cilët do t'i vihen në dispozicion publikut përmes faqes zyrtare të internetit.</p> <p>4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton të gjithë elementet e informacionit për secilin autoritet kompetent të përcaktuara sipas</p>		
--	---	--	--	---	--	--

				pikës 3 të këtij neni, jo më vonë se 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.		
Neni 4, pika 1, germa (a)	1.(a) për ujërat sipërfaqësore		Neni 20, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ndjek zbatimin e programeve të masave të përcaktuara në planet e menaxhimit të baseneve lumore për ujërat sipërfaqësorë duke siguruar:	E plotë	
Neni 4, pika 1, germa (a), nëngërma (i)	(i) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e gjëndjes të gjithë shtretërve të sipërfaqeve ujore, subjekt i aplikimit të paragrafëve 6 dhe 7 dhe pa paragjykimin e paragrafit 8.		Neni 20, pika 1, germa (a)	a) zbatimin e masave të nevojshme për të parandaluar përkeqësimin e statusit të të gjithë trupave ujorë sipërfaqësorë që janë objekt i zbatimit të neneve 24 dhe 25 të këtij ligji;	E plotë	
Neni 4 pika 1, germa (a), nëngërma (ii)	1.(a)(ii) Shtetet anëtare duhet të mbrojnë, rrisin dhe restaurojnë të gjithë shtretërit e sipërfaqeve lumore, subjekt i zbatimit të nënparagrafit 8		Neni 20, pika 1, germa (b)	b) mbrojtjen, përmirësimin dhe rehabilitimin e të gjithë trupave ujorë sipërfaqësorë, në përputhje me shkronjën “c” të kësaj pike për trupat ujorë artificiale dhe tepër të modifikuar, me qëllim arritjen e statusit të mirë kimik të ujërave sipërfaqësorë brenda 15 vjetësh pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, në përputhje me parashikimet e pikës 2 të këtij neni, që janë objekt i	E plotë	

				zbatimit të shtyrjeve të afateve të përcaktuara sipas nenit 23 dhe zbatimit të neneve 24, 25 dhe 26 të këtij ligji;		
Neni 4 pika 1, germa (a), nëngërma (iii)	1.(a)(iii) Për shtretërit ujorë artificialë dhe tejet të modifikuar, me qëllim arritjen e një statusi të mirë të sipërfaqes ujore në 15 vjetët e fundit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Shtojcën V, subjekt i zbatimit të shtesave të përcaktuara në përputhje me paragrafin 4 dhe të zbatimit të paragrafeve 5, 6 dhe 7 pa paragjykimin e paragrafit 8;		Neni 20, pika 1, germa (c)	c) mbrojtjen dhe përmirësimin e të gjithë trupave ujorë artificialë dhe tepër të modifikuar, me qëllim arritjen e potencialit të mirë ekologjik dhe statusit të mirë kimik të ujërave sipërfaqësorë, brenda 15 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të pikës 2 të këtij neni dhe në përputhje me nenet 24, 25 dhe 26 të këtij ligji;	E plotë	Referencat e vendosura në nenin 20, pika 1 germa (c) e projektligjit janë përafshuar plotësisht nga parashikimet e kësaj Direktive. (neni 24 i projektligjit me nenin 4 pika 5 dhe pika 8 të direktivës, neni 25 i projektligjit me nenin 4 pika 6 e direktivës, eni 26 i projektligjit me nenin 4 pikat 7 dhe 8 direktivës)
Neni 4 pika 1, germa (a), nëngërma (iv)	1.(a) (iv) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme në përputhje me Nenin 16 (1) dhe (8), me qëllim zvogëlimin progresiv të ndotjes nga substancat prioritare dhe ndërprerjen ose mënjanimin e shkarkimeve, lëshimeve dhe humbjeve të substancave të rrezikshme prioritare pa paragjykimin e marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare, mbështetur Neni 1 për palët e interesuara.		Neni 20, pika 1, germa (ç)	ç) zbatimin e masave të nevojshme në përputhje me dispozitat e këtij ligji që përcaktojnë standardet mjedisore të cilësisë për substancat prioritare dhe ndotës të tjerë të caktuar, me qëllim uljen progresive të ndotjes nga substancat prioritare dhe ndërprerjen apo pakësimin deri në eliminim të emetimeve, shkarkimeve dhe humbjeve të	E plotë	

				substancave prioritare të rrezikshme.		
Neni 4, pika 1, germa (c)	1.(c) për zonat e mbrojtura Shtetet anëtare duhet të arrijnë në përputhje me standardet dhe objektivat të 15 viteve të fundit pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, nëse nuk është specifikuar ndryshe në legjislacionin e Komunitetit, sipas së cilës janë krijuar zona të veçanta të mbrojtura.		Neni 21	Për zonat e mbrojtura ujore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për zonat e mbrojtura siguron arritjen e përputhshmërisë me të gjitha standardet dhe objektivat, në bazë të këtij ligji brenda 15 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin përkatës përmes së cilit janë krijuar zonat e mbrojtura individuale.	E plotë	
Neni 4, pika 3	3.Shtetet anëtare mund të caktojnë një shtrat apo sipërfaqe ujore si artificiale ose tepër të modifikuar kur:		Neni 22, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përcakton një trup ujqor sipërfaqësor si artificial apo tepër të modifikuar kur:	E plotë	
Neni 4, pika 3, germa (a)	(a)Ndryshimet ne karakteristikat hidromorfologjike të shtratit, të cilat janë të nevojshme për të arritur një gjendje ekologjike të mirë, do të kenë efekte të konsiderueshme të kundërta mbi:		Neni 22, pika 1, germa (a)	a) ndryshimet e karakteristikave hidromorfologjike të trupit, të cilat do të ishin të nevojshme për arritjen e statusit të mirë ekologjik, do të kishin ndikim negativ të konsiderueshëm në:	E plotë	
Neni 4, pika 3, germa (a)	i.Mjedisin e gjerë		Neni 22, pika 1, germa (a) nëngërma (i)	i) mjedisin rrethues;	E plotë	

nëngërma (i)						
Neni 4, pika 3, gërma (a) nëngërma (ii)	ii.Lundrimin, përfshirë pajisjet portuale ose aktivitetet rekreative		Neni 22, pika 1, germa (a) nëngërma (ii)	ii) lundrim, përfshirë ambientet portuale, apo zbatimet;	E plotë	
Neni 4, pika 3, gërma (a) nëngërma (iii)	iii.Veprimtaritë për arsye të të cilave uji është grumbulluar, si psh. furnizimi me ujë të pijshëm, sistemin energjistik dhe atë të ujitjes		Neni 22, pika 1, germa (a) nëngërma (iii)	iii)veprimtari për të cilat grumbullohet ujë, si për furnizim me ujë të pijshëm, për prodhim energjie, ose ujitje;	E plotë	
Neni 4, pika 3, gërma (a) nëngërma (vi)	(iv) rregullimi i ujit, mbrojtja nga përmytjet, kullimi i tokës, ose		Neni 22, pika 1, germa (a) nëngërma (iv)	iv) regjimin ujqor, mbrojtjen nga përmytjet, kullimin, ose	E plotë	
Neni 4, pika 3, gërma (a) nëngërma (v)	(v) aktivitete të tjera po aq të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor;		Neni 22, pika 1, germa (a) nëngërma (v)	v) veprimtari të tjera po aq të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të aktivitetit njerëzor.	E plote	
Neni 4, pika 3, germa (b)	3. (b) Objektivat përfituese të ofruara nga karakteristikat artificiale ose të modifikuara të shtratit të ujërave, nuk mund që të arrihen qoftë për arsye të përealizueshmërisë teknike apo të qenit tepër të kushtueshme, dhe që rrjedhimisht mund të arrihen me mjete të tjera, të cilat janë në mënyrë të konsiderueshme zgjidhjet më të mira mjedisore.		Neni 22, pika 1 germa (b) dhe pika 2	b) objektivat mjedisore të vendosur për trupat ujqorë për arsye të fizibilitetit teknik ose kostove të papërligjura, nuk mund të arrihen edhe me metoda të tjera, që janë alternativë shumë më e mirë mjedisore. 2. Çdo përcaktim i bërë sipas pikës 1 të këtij neni dhe arsyet përkatëse përfshihen në planet e menaxhimit të baseneve lumore.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 4, pika 3 gërma (b) e Direktivës është në përputhje me parashikimet e projektligjit. (neni 174)

	Një përcaktim i tillë dhe arsyet për të duhet të përmenden specifikisht në planet e menaxhimit sipas Nenit 13 dhe që rishikohen çdo gjashtë vjet.					
Neni 4, pika 8	8. Gjatë aplikimit të paragrafëve 3, 4, 5, 6 dhe 7, një Shtet Anëtar duhet të sigurohet që aplikimi nuk përjashton ose cënon në mënyrë të vazhdueshme arritjen e objektivave të Direktivës në trupa të tjerë të ujit brenda të njëjtit rreth të basenit lumor dhe është një përputhje me zbatimin e ligjeve të tjera të Komunitetit për mjedisin.		Neni 22 , pika 3	3. Kur zbatohen parashikimet e këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore sigurohet që zbatimi përkatës të mos përjashtojë apo cënojë në mënyrë të përhershme arritjet e objektivave mjedisorë të përcaktuara në përputhje me këtë ligj në trupat e tjerë ujorë brenda të njëjtit rajon baseni lumor dhe në përputhje me akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.	E plotë	
Neni 4, pika 4	4. Afatet e vendosura nga paragrafi 1 mund të shtyhen me qëllim arritjen e objektivave në faza nga organet që merren me ujin, me kusht që të mos ndodhë asnjë përkeqësim i mëtejshëm në gjendjen e shtrateve ujore të prekura kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:		Neni 23, pika 1	1. Afatet kohore të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 20 të këtij ligji mund të shtyhen për qëllimet e arritjes të objektivave për trupat ujorë me faza, me kusht që të mos ketë përkeqësim të mëtejshëm të statusit të trupit ujor të ndikuar kur përmbushen të gjitha kushtet në vijim:	E plotë	

Neni 4, pika 4, gërma (a)	(a) Shtetet anëtare vendosin që të gjitha përmirësimet në gjendjen e shtrateve ujore nuk mund të arrihen brenda afatave kohore të vendosura në atë paragraf për të paktën një nga arsyet e mëposhtme:		Neni 23, pika 1, germa (a)	a) Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore arrin në përfundimin se përmirësimet e nevojshme të statusit të trupit ujor nuk mund të arrihen të gjitha, brenda afateve të përcaktuara për shkak të të paktën një prej këtyre arsyeve:	E plotë	
Neni 4, pika 4, gërma (a) nëngërma (i)	i. Shkalla e përmirësimeve të nevojshme mund të arrihet në faza që e tejkalojnë afatin kohor për arsye të fizibilitetit teknik		Neni 23, pika 1, germa (a), germa (i)	i) shkalla e përmirësimeve të nevojshme mund të arrihet vetëm në faza që shkojnë përtej afateve për arsye të fizibilitetit teknik;	E plotë	
Neni 4, pika 4, gërma (a) nëngërma (ii)	ii. Plotësimi i përmirësimeve brenda afatit kohor do të jetë tepër i shtrenjtë		Neni 23, pika 1, germa (a), germa (ii)	ii) arritja e përmirësimeve brenda afateve do të kërkonte kosto joproporcionale;	E plotë	
Neni 4, pika 4, gërma (a) nëngërma (iii)	iii. Kushtet natyrore nuk lejojnë përmirësime kohore në gjendjen e shtratit ujor		Neni 23, pika 1, germa (a), germa (iii)	iii) kushtet natyrore nuk lejojnë përmirësimin në kohë të statusit të trupit ujor;	E plotë	
Neni 4, pika 4, germa (b)	4. (b) Shtyrje e afatit dhe arsyet për të janë të përcaktuara qartë dhe shpjeguar në planin e menaxhimit të basenit ujëmbledhës në Nenin 13.		Neni 23, pika 1, germa (b)	b) shtyrja e afateve dhe arsyet për shtyrjen e tyre janë të përfshira në planet e menaxhimit të baseneve lumore;	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 4, pika 4 gërma (b), është përafshuar plotësisht nga projektligji. (neni 53 dhe 174 të direktivës)
Neni 11 pika 3, germa (g)	3. (g) Për derdhjet e pikave të ndotura të cilat mund të shkaktojnë ndotje, duhet të ketë një kërkesë për një rregullim të mëparshëm, si për shembull një ndalesë për derdhjen e substancave ndotëse në ujë, ose autorizim të mëparshëm, ose regjistrim të bazuar në rregulla të përgjithshme detyruese, të përcaktuara në kontrollet për ndotësit përkatës, duke përfshirë dhe kontrolle që bëhen në përputhje me Nenin 10 dhe 16. Këto kontrolle duhet të rishikohen në mënyrë periodike dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen;		Neni 46, pika 1	1. Për shkarkimet nga burime pikësore që mund të shkaktojnë ndotje, masat themelore lidhen me ndalimin e shkarkimit në ujë të ndotësve të caktuar, kontrollin e shkarkimeve përmes lëshimit të autorizimit paraprak, ose krijimin e një regjistri të shkarkuesve, të cilat përfshijnë kontrollet e emetimeve për këto ndotës, si dhe kontrollet në përputhje me qasjen e kombinuar, sipas nenit 43 të këtij ligji dhe dispozitave të këtij ligji që përcaktojnë standardet e cilësisë mjedisore për substancat prioritare dhe ndotësit e tjerë.	E plotë	
Neni 11, pika 3, germa (h)	3.(h) Për burime të shpërndara që kanë gjasa që të shkaktojnë ndotje, duhen përcaktuar masat për të parandaluar ose kontrolluar ndikimin e ndotësve. Kontrollat		Neni 46, pika 2 dhe 4	2. Për burimet jopikësore që mund të shkaktojnë ndotje, masat themelore lidhen me ndalimin e shkarkimit në ujë të ndotësve të caktuar, kontrollin e	E plotë	

	<p>mund të marrin formën e një kërkesë për rregullime të mëparshme, si për shembull ndalimin e hedhjes/derdhjes së ndotësve në ujë, autorizim ose regjistrim paraprak bazuar në rregullat e përgjithshëm detyruese ku një kërkesë e tillë nuk është dhënë në legjislacionin e Komunitetit. Këto kontrolle duhet të rishikohen në mënyrë periodike, dhe, ku është e nevojshme, duhet të përditësohen;</p>			<p>shkarkimeve përmes lëshimit të autorizimit paraprak.</p> <p>4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore rishikon masat e përcaktuara në këtë nen në mënyrë periodike çdo 6 vjet dhe i përditëson kur është e nevojshme, si pjesë e planit të menaxhimit të basenit lumor përkatës.</p>		
<p>Neni 11, pika 3</p>	<p>3.(i)Për çdo ndikim tjetër domethënës negativ në statusin e ujit të identifikuar në Nenin 5 të Shtojcës II, në veçanti masat për të siguruar që kushtet hidromorfologjike të trupave të ujit janë në përputhje me arritjet e statusit ekologjik të kërkuar ose të potencialit të mirë ekologjik për trupat e ujit të përcaktuar si artificiale ose të modifikuar rëndë. Kontrollat për këtë qëllim mund të marrin formën e një kërkesë për një autorizim ose regjistrim paraprak bazuar në rregullat e përgjithshme detyruese, ku një kërkesë e tillë nuk është parashikuar në legjislacionin e Komunitetit. Këto kontrolle duhet të rishikohen në mënyrë periodike</p>		<p>Neni 46, pika 3 dhe 4</p>	<p>3. Për çdo ndikim tjetër negativ të paktheshëm në statusin e trupit ujor të identifikuar sipas karakterizimit fillestar të kryer në përputhje me nenin 27 të këtij ligji, identifikohen masa për të garantuar që kushtet hidromorfologjike të trupave ujorë të shpallur si artificiale ose tepër të modifikuar, të jenë në përputhje me arritjen e statusit të kërkuar ekologjik ose potencialin e mirë ekologjik për trupat ujorë. Kontrollat për këtë qëllim mund të marrin formën e një kërkesë për autorizim paraprak ose regjistrim bazuar në rregulla të përgjithshme detyruese, kur një kërkesë e tillë nuk parashikohet ndryshe nga legjislacioni.</p>	<p>E plotë</p>	

	dhe, ku është e nevojshme, duhet të përditësohen.			4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore rishikon masat e përcaktuara në këtë nen në mënyrë periodike çdo 6 vjet dhe i përditëson kur është e nevojshme, si pjesë e planit të menaxhimit të basenit lumor përkatës.		
Neni 11, pika 3, germa (k)	3.(k) në përputhje me veprimet e ndërmarra sipas Nenit 16, masat për të zhdukur ndotjen nga ujrat nëntokësorë nga ato substanca të specifikuar në listën e substancave parësore të rëna dakort sipas Nenit 16(2) dhe për të ulur ndotjen në mënyrë të vazhdueshme nga substanca të tjera, të cilat nuk do t'u lejonin shteteve anëtare të plotësojnë objektivat për trupat sipërfaqësorë të ujit të parashikuar në Nenin 4;		Neni 47, pika 1	1. Për eliminimin e ndotjes dhe parandalimin e emetimeve të konsiderueshëm të ndotësve, masat themelore përbëhen nga masat për eliminimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë nga ato substanca të përfshira në listën e substancave prioritare të identifikuar sipas përcaktimeve në nenin 67 të këtij ligji dhe për të zvogëluar në mënyrë progresive ndotjen nga substanca të tjera, të cilat do të pengonin arritjen e objektivave për trupat ujorë sipërfaqësorë të përcaktuara në nenet 20 dhe 21 të këtij ligji.	E plotë	
Neni 11, pika 3, germa (l)	3.(l) çdo masë që nevojitet për të shmangur humbjet e konsideruara të ndotësve nga instalimet teknike dhe për të shmangur dhe/ose ulur ndikimet e incidenteve të ndotjeve aksidentale për shembull si rezultat i përmytjeve, duke përfshirë sistemet për diktimin ose dhënie të paralajmërimit për ngjarje të tilla, duke përfshirë		Neni 47, pika 2	2. Do të konsiderohen si masa themelore të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar emetimet e ndotësve në mjedis nga instalimet industriale, dhe për të parandaluar ose për të zvogëluar ndikimin e ndotjes aksidentale, për shembull si rezultat i përmytjeve, si dhe masat e ndërmarra përmes sistemeve të paralajmërimit të hershëm të ngjarjeve të tilla, duke përfshirë rastet e aksidenteve të	E plotë	

	dhe rastin e aksidenteve të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të parashikohen si dhe të gjitha masat e duhura për të ulur rreziqet e ekosistemeve ujore.			cilat nuk mund të parashikoheshin për të marrë të gjitha masat e duhura për të zvogëluar riskun në ekosistemet ujore.		
Neni 11, pika 4	4. Masat “shtesë” janë ato masa të cilat janë hartuar dhe zbatohen si shtojcë e masave bazë, me qëllimin e arritjes së objektivave të përcaktuara në bazë të nenin 4. Pjesa B e Shtojcës IV përmban një listë jo ekskluzive të masave të tilla. Shtetet anëtare mund të miratojnë masa të tjera shtesë në mënyrë që të sigurojnë mbrojtje më të mirë ose përmirësim të ujërave të mbuluar nga kjo Direktivë, duke përfshirë zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilave u referohet Nenin 1.		Neni 48, pika 1	1. Masat plotësuese janë masat e hartuara dhe zbatuara përveç masave themelore, me qëllim arritjen e objektivave sipas përcaktimeve në nenet 20, 21, dhe 56 të këtij ligji.	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B	Pjesa B Lista e mëposhtme është një listë joekskluzive e masave shtesë të cilat shtetet anëtare brenda secilit distrikt të basenit ujor mund të zgjedhin që t'i miratojnë, si pjesë e programit të masave të kërkuara sipas Nenit 11(4):		Neni 48, pika 2	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për çdo rajon baseni lumor, baseni ndërkombëtar lumor ose baseni ndërkombëtar liqenor, mund të përfshijë masa plotësuese si pjesë e programit të masave të kërkuara në zbatim të nenit 44 të këtij ligji, të cilat ndër të tjera konsistojnë në:	E plotë	Neni 11, pika 4 e Direktivës është transpozuar nga parashikimet e projektligjit. (neni 48, pika 1)
Shtojca VI, pjesa B (i)	(i) instrumentet legjislativë		Neni 48, pika 2 (a)	a) instrumente legjislativë;	E plotë	

Shtojca VI, pjesa B (ii)	(ii) instrumentet adminisitrative		Neni 48, pika 2 (b)	b) instrumente administrative;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (ii)	(iii) instrumentet ekonomike ose fiskale		Neni 48, pika 2 (c)	c) instrumente ekonomike ose fiskale;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (vi)	(iv) marrëveshjet mjedisore të integruara		Neni 48, pika 2 (ç)	ç) marrëveshje mjedisore të negociuara;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (v)	(v) kontrollet e daljeve		Neni 48, pika 2 (d)	d) kontrolle të emetimeve;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (vi)	(vi) kodet e praktikave të mira		Neni 48, pika 2 (dh)	dh) kodet e praktikave të mira;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (vii)	(vii) rikrijimi dhe ruajtja e zonave të tokave të lagura		Neni 48, pika 2 (e)	e) rikrijim dhe restaurim të zonave ligatinore;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (viii)	(viii) kontrollet e nxjerrjes		Neni 48, pika 2 (ë)	ë) kontroll të shfrytëzimit;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (ix)	(ix) masa për menaxhimin e kërkesës, inter alia, nxitja e prodhimit bujqësor si për shembull rritja e drithërave që nuk kërkojnë shumë ujë në zonat që preken nga thatësia		Neni 48, pika 2 (f)	f) masa të menaxhimit të kërkesës, ndër të tjera, promovimin e prodhimit bujqësor të përshtatur siç janë kulturat me kërkesë të ulët për ujë në zonat e prekura nga thatësira;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (x)	(x) masa për efikasitet, iner alia, nxitja e teknologjive që e përdorin ujin me kursim në industri dhe teknikat ujitëse që kursejnë ujë		Neni 48, pika 2 (g)	g) masa të efikasitetit dhe ripërdorimit, ndër të tjera, promovimin e teknologjive me efikasitet në përdorimin e ujit në industri dhe teknikat e ujitjes që kursejnë ujë;	E plotë	

Shtojca VI, pjesa B (xi)	(xi) projektet e ndërtimit		Neni 48, pika 2 (g)	gj) projekte ndërtimi;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (xii)	(xii) impiantet e heqjes së kripës		Neni 48, pika 2 (h)	h) impiante shkripëzimi;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (xiii)	(xiii) projekte rehabilitimi		Neni 48, pika 2 (i)	i) projekte rehabilitimi;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (xiv)	(xiv) rimbushja artificiale e ujëmbajtësve		Neni 48, pika 2 (j)	j) ripërtëritje artificiale të akuiferëve;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (xv)	(xv) projektet edukative		Neni 48, pika 2 (k)	k) projekte edukative;	E plotë	
Shtojca VI, pjesa B (xvi) dhe (xvii)	(xvi) projekte kërkimore, zhvillimi dhe demonstrimi (xvii) masa të tjera të përkatëse		Neni 48, pika 2 (l)	l) projekte kërkimi, zhvillimi dhe demonstrimi.	E plotë	
Neni 11, pika 5	5.Kur monitorimi ose të dhëna të tjera dëshmojnë se objektivat e përcaktuara në Nenin 4 për trupin e ujit nuk ka të ngjarë që të arrihen, shtetet anëtare duhet të sigurohen që:		Neni 49, pika 1	1. Kur nga të dhënat e monitorimit konstatohet se objektivat e cilësisë mjedisore të përcaktuara në nenet 20, 21 dhe 56 të këtij ligji nuk arrihen për një trup ujur të caktuar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore kryen:	E plotë	
Neni 11, pika 5, ndarja e parë	-shkaqet e dështimit të mundshëm janë hetuar,		Neni 49, pika 1, germa (a)	a) hetimin e shkaqeve të mundshëm;	E plotë	
Neni 11, pika 5, ndarja e dytë	-janë shqyrtuar dhe janë rishikuar ashtu siç duhet lejet dhe autorizimet përkatëse;		Neni 49, pika 1, germa (b)	b) shqyrtimin dhe rishikimin rast pas rasti të lejeve dhe autorizimeve përkatëse;	E plotë	

Neni 11, pika 5, ndarja e tretë	-janë rishikuar programet e monitorimit, të cilave u janë bërë rregullimet përkatëse dhe;		Neni 49, pika 1, germa (c)	c) rishikimin dhe përshtatjen e duhur të programeve të monitorimit; dhe	E plotë	
Neni 11, pika 5 ndarja e katërt	-janë përcaktuar masa shitesë të nevojshme për të arritur objektivat e përcaktuara, duke përfshirë, sipas rastit, vendosjen e cilësore standardeve strikte për mjedisin e ndjekur procedurat e parashtruara në Shtojcën V.		Neni 49, pika 1, germa (ç)	ç) përcaktimin e masave shitesë sipas nevojës për të arritur këto objektiva, përfshi sipas rastit, përcaktimin e standardeve më shtrënguese të cilësisë mjedisore sipas përcaktimeve në nenin 67, pika 2 e këtij ligji.	E plotë	
Neni 11, pika 5 paragrafi 2	5 paragrafi 2 - Kur këto shkaqe janë rezultat i rrethanave të shkaqeve natyrore ose si rezultat i forcës madhore, raste të cilat janë përjashtimore dhe nuk mund të parashikohen në bazë të arsyes, si për shembull përmbytjet ekstreme ose thatësirat shumë të gjata, shtetet anëtare mund të përcaktojnë se masat shitesë nuk janë të praktikueshme (Neni 4(6)).		Neni 49, pika 2	2. Kur mosarritja e objektivave sipas pikës 1 të këtij neni vjen si rezultat i rrethanave natyrore ose forcës madhore, të cilat nuk mund të parashikoheshin, në veçanti në rastin e përmbytjeve ekstreme dhe thatësirave të tejzgjatura, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore mund të deklarojë se masat plotësuese nuk janë të zbatueshme praktikisht, në varësi të nenit 46 të këtij ligji.	E plotë	
Neni 11, pika 6	6. Në zbatimin e masave sipas paragrafit 1, shtetet anëtare duhet të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të mos rritur ndotjen e ujërave të marinës. Pa paragjykuar legjislacionin ekzistues, aplikimi i masave të marra sipas paragrafit 3, mund të mos çojë qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në një nivel më të lartë ndotjeve të ujërave		Neni 50, pika 1	1. Gjatë zbatimit të masave sipas neneve 45, 46 dhe 47 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ndërmerri hapa të përshtatshëm që të mos shtohet ndotja e ujërave detare. Zbatimi i masave të marra sipas neneve 45, 46 dhe 47 të këtij ligji, nuk mund të çojë në asnjë mënyrë në shtimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ndotjes së ujërave sipërfaqësore.	E plotë	

	tokësore. Kjo kërkesë nuk do të aplikohet kur ajo rezulton në një rritje të ndotjes së mjedisit si i tërë.					
Neni 11, pika 7	7. Programet e masave duhet të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme duhet të përditësohen jo më vonë se 15 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj direktive, dhe një herë në çdo gjashtë vjet pas asaj kohe. Çdo masë e re ose e rishikuar e përcaktuar nën një program të përditësuar, do të vihet në jetë brenda periudhës kohore prej tre vjetësh pas përcaktimit.		Neni 51, pika 2	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton programet e masave të përmendura në nenin 44 të këtij ligji brenda 9 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe sigurohet që të gjitha masat vihen në zbatim brenda 12 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.	E plotë	
Neni 12, pika 1	1. Kur një shtet anëtar identifikon një çështje që ka ndikim mbi ujin e tij, por që nuk mund të zgjidhet nga shteti anëtar, ai mund t'ia raportojë çështjen Komisionit dhe çdo shtet tjetër anëtar, dhe mund të bëjë rekomandime për zgjidhjen e çështjes.		Neni 52	Nëse Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore identifikon një problematikë, e cila ndikon në menaxhimin e burimeve ujore, por që nuk mund të zgjidhet, mund të japë rekomandime lidhur me zgjidhjen për të cilën informon Këshillin e Ministrave, me synim përcjelljen e çështjes në Komisionin e Bashkimit Evropian.	E plotë	
Neni 13, pika 1	1. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se plani i menaxhimit të basenit lumor bëhet për çdo rreth të basenit lumor që shtrihet tërësisht në territorin e tyre përkatës.		Neni 53, pika 1	1. Planet e menaxhimit të baseneve lumore dhe, kur është rasti, planet e menaxhimit të baseneve liqenore, miratohen dhe publikohen në përputhje me këtë ligj.	E plotë	
Neni 13, pika 2	2. Në rastin e rretheve të baseneve ndërkombëtare të		Neni 53, pika 2 dhe 3	2. Në rastin e menaxhimit të baseneve lumore ndërkufitare dhe	E plotë	

	lumenjve të cilat janë plotësisht pjesë e Komunitetit, shtetet anëtare duhet të sigurojnë koordinimin me qëllimin e nxjerrjes/përgatitjes së një plani menaxhimi për basenin lumor. Në rastet kur një plan i tillë për menaxhimin e basenit të lumit ndërkombëtar nuk realizohet, shtetet anëtare duhet të prodhojnë plane menaxhimi për basenet lumore, duke mbuluar taksën për ato pjesë të rrjetit të basenit të lumit ndërkombëtar që shtrihen në territoret e tyre, për të arritur objektivat e kësaj Direktive.			rajoneve ndërkufitare të menaxhimit të baseneve liqenore që ndodhen brenda territorit të Shqipërisë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron bashkërendimin me shtetet e tjera ku ndodhen këto basene me qëllim hartimin e një plani të vetëm të menaxhimit të basenit lumor nëse është e mundur edhe nga shteti apo shtetet ndërkufitare. 3. Kur bashkërendimi në përputhje me pikën 2 të këtij neni nuk ka sjellë hartimin e një plani të vetëm të menaxhimit të basenit lumor, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton planin e menaxhimit të basenit lumor të paktën për atë pjesë të basenit ndërkufitar lumor dhe liqenor që ndodhet në territorin e Shqipërisë, me qëllim arritjen e objektivave të cilësisë mjedisore të përcaktuara në përputhje me nenet 20, 21 dhe 56 të këtij ligji.		
Neni 13, pika 4	4. Plani i menaxhimit të basenit lumor duhet të përfshijë informacionin e dhënë në mënyrë të detajuar në Shtojcën VII.		Neni 53, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përcakton elementet që përmban një plan menaxhimi i basenit lumor dhe të gjithë elementet që duhet të përfshihen në të gjithë përditësimet e planeve të menaxhimit të baseneve lumore.	E plotë	
Shtojca VII	PLANET E MENAXHIMIT TE BASENEVE LUMORE		Neni 53, pika 5	5. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton elementet e përcaktuara	E pjesshme	Pika 5 e nenit 53 autorizon KM për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të

				në pikën 4 të këtij neni, jo më vonë se 90 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon planet e menaxhimit të baseneve lumore të hartuara në përputhje me këtë nen, brenda 9 vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.		transpozojë plotësisht shtojcën VII
Neni 13, pika 7	7. Planet e menaxhimit të baseneve lumore do të rishikohen dhe të përditësohen jo më vonë se 15 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive dhe do të rishikohen dhe përditësohen një herë në gjashtë vjet, pas asaj kohe.		Neni 53, pika 6	6. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore rishikon dhe përditëson planet e menaxhimit të baseneve lumore brenda 15 vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe çdo 6 vjet në vijim.	E Plotë	
Neni 14, pika 1	1. Shtetet anëtare do të përkrahin përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara në zbatimin e kësaj Direktive, veçanërisht në prodhimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të baseneve lumore.		Neni 54, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore garanton përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara për zbatimin e këtij ligji, veçanërisht sa i përket hartimit, rishikimit dhe përditësimin të planeve të menaxhimit të baseneve lumore.	E plotë	
Neni 14, pika 1	Shtetet anëtare duhet të sigurohen se për secilin rreth të basenit lumor ata nxjerrin botime dhe i ofrojnë publikut dhe përdoruesve për materialet e mëposhtme:		Neni 54, pika 2	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për çdo Rajon Baseni Lumor publikon dhe vë në dispozicion për komente nga publiku, përfshi përdoruesit, sa më poshtë:	E plotë	
Neni 14, pika 1, germa (a)	(a) një grafik dhe një program pune për nxjerrjen e planit, duke përfshirë një		Neni 54, pika 2, germa (a)	a) afatet dhe programin e punës për hartimin e planit, përfshi deklaratën lidhur me masat	E plotë	

	deklaratë për masat që do të merren për konsultim, të paktën tre vite përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet plani;			që do të ndërmerren për konsultim, të paktën 3 vjet përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet plani;		
Neni 14, pika 1, germa (b)	(b) një vështrim të plotë të brendshëm të çështjeve domethënëse të menaxhimit të ujit të identifikuar në basenin e lumit, të paktën dy vjet përpara fillimit të periudhës që i referohet plani. Nëse kërkohet, do të jepet akses për dokumentet bazë dhe informacionin e përdorur për zhvillimin e projektit të planit të menaxhimit të basenit lumor.		Neni 54, pika 2, germa (b) dhe (c)	b) deklaratën e problematikave të rëndësishme të menaxhimit të burimeve ujore në basenin lumor, të paktën 2 vjet përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet plani; c) projektplanin e menaxhimit të basenit lumor, të paktën 1 vit përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet plani. Sipas kërkesës, publikut i jepet akses në dokumentacionin dhe informacionin bazë që është përdorur për hartimin e projektplanit të menaxhimit të basenit lumor.	E plotë	
Neni 14, pika 2	2. Shtetet anëtare duhet të lejojnë të paktën gjashtë muaj për të komentuar këto dokumente me shkrim, në mënyrë që të lejohet një pjesëmarrje dhe proces konsultimi aktiv.		Neni 54, pika 3	3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore vë në dispozicion të publikut informacionet sipas pikës 2 të këtij neni, për një periudhë kohore prej të paktën 6 muaj për komente me shkrim.	E plotë	
Neni 14, pika 3	3. Paragrafi 1 dhe 2 do të aplikohet në mënyrë të barabartë mbi planet e menaxhimit të basenit lumor.		Neni 54, pika 4	4. Pikat 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen edhe për përditësimet e planeve të menaxhimit të baseneve lumore.	E plotë	
Neni 15, pika 1	1. Shtetet anëtare duhet t'i dërgojnë Komisionit kopje të planeve të menaxhimit të basenit		Neni 55, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore i dërgon kopje të planeve të menaxhimit të	E plotë	

	<p>lumor si dhe kopje pasardhëse të përditësuara. Kopje të njëja duhet t'i dërgohen dhe Shteteve Anëtare të interesuara brenda një periudhë tremujore nga botimi i tyre;</p> <p>(a) për rrethet e baseneve lumore që janë plotësisht pjesë e territorit të vendeve anëtare, të gjitha planet e menaxhimit të lumenjve që mbulojnë atë territor dhe të botuara sipas Nenit 13;</p> <p>(b) për rrethet e baseneve ndërkombëtare të lumenjve, të paktën pjesën e planeve të menaxhimit të basenit lumor që mbulon territorin e shtetit anëtar.</p>			<p>baseneve lumore dhe të gjitha përditësimeve të tyre vijuese, vendeve fqinje të përfshira, Agjencisë Evropiane të Mjedisit dhe organeve të tjera të interesuara të Bashkimit Evropian, dhe i vë ato në dispozicion të publikut në faqen zyrtare të internetit brenda 3 muajsh nga miratimi dhe publikimi i tyre.</p>		
<p>Neni 15, pika 2, paragrafi i parë</p>	<p>2. Shtetet anëtare duhet të paraqesin raportet përmbledhëse të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizës që kërkohet sipas Nenit 5 dhe - programet e monitorimit të përcaktuara në Nenin 8 <p>të ndërmarra për qëllimet e planit të parë të basenit të lumit, brenda tre muajsh nga përfundimi i tyre.</p>		<p>Neni 55, pika 2</p>	<p>2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon raportet përmbledhëse të analizave të kërkuara sipas neneve 27 dhe 28 të këtij ligji dhe të programeve të monitorimit të hartuara sipas nenit 41 të këtij ligji, të përgatitura në kuadër të hartimit të planit të parë të menaxhimit të basenit lumor, brenda 3 muajsh nga përfundimi i tyre.</p>	<p>E plotë</p>	

Neni 15, pika 2 pragrafi 2	2 (paragrafi 2) Shtetet anëtare, brenda tre vjetësh nga botimi i planit të menaxhimit të basenit lumor ose përditësimit të parashikuar në Nenin 1, duhet t'i paraqesin një raport të brendshëm që përshkruan arritjet në zbatimin e programit të planifikuar të masave.		Neni 55, pika 3	3. Brenda 3 vjetësh nga publikimi ose përditësimi i çdo plani menaxhimi të baseneve lumore në përputhje me këtë ligj, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore i paraqet publikut një raport të ndërmjetëm që përshkruan ecurinë e zbatimit të programeve të masave të planifikuara.	E plotë	
Neni 4, pika 1, germa (b), nëngërma (i)	Pika 1 (b)(i) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme për të parandaluar ose kufizuar inputet e ndotësve në ujërat nëntokësore dhe të parandalojnë prishjen e gjendjes së shtretërve të gjithë ujërave nëntokësore, subjekt i zbatimit të paragrafëve 6 dhe 7 dhe pa paragrykimin e paragrafit 8 të këtij Neni dhe subjekt të zbatimit të Nenit 11(3)(j);		Neni 56, pika 2, germa (a)	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ndjek zbatimin e programeve të masave për ujërat nëntokësore të përcaktuar në planet e menaxhimit të baseneve lumore, duke siguruar: a) zbatimin e masave të nevojshme për parandalimin ose kufizimin e futjes së ndotësve në ujërat nëntokësore dhe për parandalimin e përkeqësimit të statusit të trupave të ujërave nëntokësore, në përputhje me nenet 58 dhe 65 të këtij ligji;	E Plotë	
Neni 4, pika 1, germa b, nëngërma (ii)	Pika 1 (b)(ii) Shtetet anëtare duhet të mbrojnë, përforcojnë dhe restaurojnë të gjithë shtretërit e ujërave nëntokësore, të sigurojnë një baraspeshë midis rrjedhjes dhe rimbushjes së ujërave nëntokësore, me qëllim arritjen e një gjendje të mirë të ujërave nëntokësore në 15 vjetët e fundit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, në përputhje me dispozitat e		Neni 56 pika 2, germa (b)	b) mbrojtjen, përmirësimin dhe rehabilitimin e të gjithë trupave ujorë nëntokësore, si dhe ruajtjen e ekuilibrit midis sasisë që shfrytëzohet dhe rimbushjes së ujërave nëntokësore, me qëllim arritjen e statusit të mirë të ujërave nëntokësore, brenda 15 vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në përputhje me nenet 36 dhe 62 të këtij ligji;	E plotë	Neni 11 pika 3 germa (j) e Direktivës është transpozuar nga parashikimet e projektligjit (neni 65)

	përcaktuara në Shtojcën V, subjekt i zbatimit të shtesave të përcaktuara në përputhje me paragrafin 4 dhe të zbatimit të paragrafeve 5, 6 dhe 7 pa paragjykimin e paragrafit 8 të këtij Neni dhe subjektin e zbatimit të Nenit 11(3)(j);					
Neni 4 pika 1, germa b, nëngërma (iii)	<p>Pika 1. (b) (iii) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme për të ndryshuar ndonjë prirje të qëndrueshme në rritje në përqëndrimin e ndonjë ndotësi që vjen nga impakti i aktivitetit njerëzor me qëllim që progresivisht të zvogëlojnë ndotjen e ujërave nëntokësore.</p> <p>Masa për të arritur drejtime të ndryshme do të zbatohet në përputhje me paragrafet 2, 4 dhe 5 të Nenit 17, duke marrë në konsideratë standardet e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin përkatës të Komunitetit, subjekt i aplikimit të paragrafëve 6 dhe 7 pa paragjykimin e paragrafit 8;</p>		Neni 56, pika 2, gërma (c)	c) zbatimin e masave të nevojshme për përmbysjen e të gjitha prirjeve rritëse të konsiderueshme dhe të qëndrueshme, lidhur me përqëndrimin e çdo ndotësi që vjen si pasojë e ndikimit të aktivitetit njerëzor, me qëllim uljen progresive të ndotjes në ujërat nëntokësorë. Masat për të arritur përmbysjen e prirjes zbatohen në përputhje me nenet 45 dhe 46 të këtij ligji, si dhe përcaktimet sipas nenit 64 të këtij ligji, duke marrë në konsideratë standardet e zbatueshme të përcaktuara në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër përkatës.	E plotë	
Neni 5, pika 1	1. Çdo vend anëtar duhet të sigurohet se për çdo rreth të basenit ujor ose për përqindjen e një rrethi ndërkombëtar të basenit ujor që është pjesë e territorit të tij		Neni 57, pika 1 dhe 2	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për çdo rajon të basenit lumor apo për pjesë të një baseni lumor apo liqenor ndërkufitar që ndodhet në	E plotë	

	<ul style="list-style-type: none"> - të bëhen analizat e karakteristikave të tij, - të bëhet një rishim i ndikimit të aktivitetit të njeriut mbi statusin e ujërave sipërfaqësore ose ujërave tokësore, dhe - një analizë ekonomike e përdorimit të ujit në bazë të specifikimeve teknike të parashtruara në Shtojcën II dhe III dhe që ato të jenë bërë gjatë harkut kohor të katër viteve të fundit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive. 			<p>territorin e Republikës së Shqipërisë, siguron kryerjen e:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) analizës së karakteristikave të tij lidhur me ujërat nëntokësorë; b) vlerësimit të ndikimit të aktivitetit njerëzor mbi statusin e trupave ujorë nëntokësorë; c) vlerësimit të ndikimit të ndryshimeve në nivelet e ujërave nëntokësorë; dhe ç) vlerësimit të ndikimit të ndotjes në cilësinë e ujërave nëntokësorë. <p>2. Analiza dhe vlerësimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, do të kryhen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me institucionet monitoruese për ujërat nëntokësorë brenda 4 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p>		
Neni 5, pika 2	2. Analizat dhe rishikimet e përmendura në paragrafin 1 do të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme, do të përditësohen jo më vonë se 13 vjet pas hyrjes së kësaj Direktive në fuqi, dhe çdo gjashtë vjet pas kësaj kohe.		Neni 57, pika 3	3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me institucionet monitoruese për ujërat nëntokësorë përditëson analizën dhe vlerësimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni çdo 6 vjet, në kuadër të rishikimit dhe përditësimit të planit të menaxhimit të basenit lumor.	E plotë	
Shtojca II, pika 2	2.Ujërat nëntokësorë		Neni 57, pika 4	4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton specifikimet teknike për kryerjen e analizës dhe	E pjesëshme	Pika 4 e nenit 57 përcakton bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të transpozohet plotësisht pjesët

				vlerësimeve, të listuara në pikën 1 të këtij neni, brenda 4 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.		përkatëse të shtojcave të përmendura në kolonën përkatëse.
Neni 11, pika 3 germa (e)	3. (e) Kontrolllet për nxjerrjen e ujit të freskët sipërfaqësor dhe nëntokësor, dhe marrjen e ujit të freskët sipërfaqësor duke përfshirë dhe një regjistër ose regjistra për nxjerrjen e ujit dhe një kërkesë për një autorizim paraprak për nxjerrjen dhe perpunimin. Kontrolllet duhet të ndërmerren në mënyrë periodike dhe, nëse është e nevojshme, të përditshme. Shtetet anëtare presin nga keto kontrolle nxjerrje dhe perpunim, i cili nuk ka impakt ne gjendjen e ujit.		Neni 58, pika 1, germa (a)	a) kontrollin mbi shfrytëzimin e ujërave nëntokësorë, përmes pajisjes me leje apo autorizim si dhe krijimin e një regjistri të shfrytëzimit të ujërave nëntokësorë. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore mund të përjashtojë nga ky kontroll nxjerrjet që nuk kanë ndikim domethënës në statusin e ujit;	E plotë	
Neni 11, pika 3, germa (f)	3.(f) Kontrolle, duke përfshirë një kërkesë për një autorizim paraprak për rifurnizimin artificial ose rritjen e trupave nënujore. Uji i përdorur mund të vijë nga çdo ujë sipërfaqësor ose ujë nëntokësor, për aq kohë sa përdorimi i burimit nuk çënon arritjen e objektivave mjedisore për burimin, trupin e rifurnizuar ose të rritur të ujit nëntokësor, Këto kontrolle do të rishikohen në mënyrë periodike dhe, atëherë kur të jetë e nevojshme, do të përditësohen;		Neni 58, pika 1, germa (b)	b) kontrollin mbi rimbushjen dhe furnizimin artificial të trupave ujorë nëntokësorë, përmes pajisjes me leje apo autorizim. Uji i përdorur për rimbushje apo furnizimin artificial, merret nga çdo trup ujq sipërfaqësor dhe nëntokësor, me kusht që përdorimi i burimit të mos vërë në rrezik arritjen e objektivave mjedisorë të përcaktuara për këtë burim dhe për trupin ujq nëntokësor që rimbushet.	E plotë	

Shtojca V, pika 2	2.Ujërat nëntokësorë		Neni 59, pika 3	3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton specifikimet teknike për kryerjen e monitorimeve të statusit sasior dhe kimik për ujërat nëntokësorë, brenda 4 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	E pjeshme	Pika 3 e nenit 59 përcakton bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të transpozohet plotësisht pjesët përkatëse të shtojcave të përmendura në kolonën përkatëse.
Neni 11, pika 3, germa (j)	(j) Një ndalim për hedhjet e drejtpërdrejta të ndotësve në subjektin nënujor sipas dispozitave të mëposhtme: Shtetet anëtare mund të autorizojnë riinjeksionin e ujit të përdorur për qëllime gjeotermale në të njëjtin akuifer. Ata mund të autorizojnë gjithashtu, duke specifikuar kushtet për:		Neni 65, pikat 1, 2, 3	1. Injektimi i ndotësve në ujërat nëntokësorë si rregull është i ndaluar, përveçse në rastet e parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni. 2. Organet e menaxhimit të burimeve ujore mund të autorizojnë riinjektimin në të njëjtin akuifer të ujërave që përdoren për qëllime gjeotermale. 3. Organet e menaxhimit të burimeve ujore duke specifikuar kushtet përkatëse mund të autorizojnë gjithashtu:	E Plotë	
Neni 11, pika 3, germa (j), ndarja e parë	- injektimin e substancave që përmbajnë ujë që shkaktohen nga veprimet për të zbuluar dhe nxjerrë hidrokarbure ose aktivitete minerare, injektimin e ujit në formacionet gjeografike nga të cilat janë nxjerrë hidrokarburet ose substancat e tjera për arsye teknike, ose injektimin në formacione gjeologjike të cilat si pasojë e arsyeve natyrore janë të papërshtatshme për qëllime të tjera. Injektione të tilla nuk		Neni 65, pika 3 germa (a)	a) injektimin e ujërave që përmbajnë substanca që vijnë si pasojë e veprimtarive për eksplorimin dhe nxjerrjen e hidrokarbureve ose veprimtarive minerare, dhe injektimin e ujërave për arsye teknike në formacione gjeologjike nga të cilat janë nxjerrë hidrokarbure dhe substanca të tjera, ose në formacione gjeologjike të cilat për arsye natyrore nuk janë më asnjëherë të përshtatshme për qëllime të tjera. Këto ujëra nuk	I plotë	

	duhet të përmbajnë substanca të tjera të ndryshme nga ato që vijnë si rezultat i veprimeve të mësipërme,			duhet të përmbajnë substanca të tjera përveç atyre që vijnë si pasojë e veprimtarive të mësipërme;		
Neni 11, pika 3, germa (j), ndarja e dytë	- rinjektimi i ujit nëntokësor të pompuar nga minierat dhe gërmimet ose të shoqëruara nga ndërtimi ose mirëmbajtja e veprave inxhinierike civile;		Neni 65, pika 3 germa (b)	b) riinjektimin e ujërave nëntokësore të marra me pompa nga minierat dhe guroret ose që lidhen me ndërtimin apo mirëmbajtjen e veprave të punimeve civile;	I plotë	
Neni 11, pika 3, germa (j), ndarja e tretë	- injektimin e gazit natyror ose të LPG-së (gaz petroleumi të lëngëzuar) për qëllime ruajtjeje në formacionet gjeografike, të cilat, për arsye natyrore, janë të papërshtatshme për qëllime të tjera;		Neni 65, pika 3 germa (c) dhe (ç)	c) injektimin e gazit natyror ose gazit të lëngëzuar të naftës për qëllime të magazinimit në formacione gjeologjike, të cilat për arsye natyrore nuk mund të përdoren asnjëherë për qëllime të tjera; ç) injektimin e rrjedhave të dioksidit të karbonit për qëllime magazinimi në formacione gjeologjike të cilat për arsye natyrore nuk mund të përdoren më për qëllime të tjera, me kusht që ky injektim të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi;	I plotë	
Neni 11, pika 3, germa (j), ndarja e katërt	- injektimin e gazit natyror ose të LPG-së për qëllime ruajtjeje në formacione të tjera gjeografike ku ka një nevojë të ngutshme për sigurimin e furnizimit me gaz dhe ku injektimi parandalon		Neni 65, pika 3 germa (d)	d) injektimin e gazit natyror ose gazit të lëngëzuar të naftës për qëllime depozitimi në formacione të tjera gjeologjike kur ka nevojë të madhe për sigurinë e furnizimit me gaz, dhe kur injektimi parandalon çdo	I plotë	

	çdo rrezik aktual ose të ardhshëm për përkeqësimin e cilësisë së ujit nëntokësor të marrë,			rrezik aktual apo të ardhshëm lidhur me përkeqësimin e cilësisë së ujërave nëntokësorë pritëse;		
Neni 11, pika 3, germa (j), ndarja e pestë	- veprat e ndërtimit, të inxhinierisë civile, ndërtesat dhe aktivitete të ngjashme në brendësi ose në sipërfaqe, të cilat janë në kontakt me ujin nëntokësor. Për këto qëllime, shtetet anëtare mund të përcaktojnë se aktivitete të tilla do të trajtohen si të autorizuar, me kusht që ato të ndërtohen në përputhje me rregullat e përgjithshme detyruese të hartuara nga shtetet anëtare përsa u përket aktiviteteve të tilla,		Neni 65, pika 3 germa (dh)	dh) ndërtimin, veprat e punimeve civile dhe punimet ndërtimore dhe veprimtari të ngjashme mbi, ose në tokë, të cilat krijojnë kontakt me ujërat nëntokësorë. Për këto qëllime, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore mund të përcaktojë se këto veprimtari duhet të trajtohen si veprimtari të autorizuar, me kusht që ato të kryhen në përputhje me rregullat e përgjithshme detyruese të hartuara nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ose autoritete të tjera kompetente lidhur me këto veprimtari;	I plotë	
Neni 11, pika 3, germa (j), ndarja e gjashtë	- hedhjet e sasive të vogla të substancave për qëllime shkencore për karakterizimin, mbrojtjen dhe ndreqjen e trupave ujore të kufizuar në sasinë të nevojshme për qëllimet në fjalë		Neni 65, pika 3 germa (e)	e) shkarkimin e sasive të vogla të substancave për qëllime shkencore lidhur me karakterizimin, mbrojtjen ose korrigjimin e trupave ujorë, të kufizuar rreptësisht në sasinë e nevojshme për qëllimet përkatëse, me kusht që këto shkarkime të mos vënë në rrezik arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara për atë trup ujor nëntokësor.	I plotë	

Shtojca VIII	Lista treguese e ndotësve kryesorë		Neni 66, pika 4	4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton listën indikative të ndotësve të identifikuar sipas pikës 3 të këtij neni, brenda 4 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	E pjeshme	Pika 4 e nenit 66 përcakton bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të transpozohet plotësisht pjesët përkatëse të shtojcave të përmendura në kolonën përkatëse.
Neni 13	<p>1. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se plani i menaxhimit të basenit lumor bëhet për çdo rreth të basenit lumor që shtrihet tërësisht në territorin e tyre përkatës.</p> <p>2. Në rastin e rretheve të baseneve ndërkombëtare të lumenjve të cilat janë plotësisht pjesë e Komunitetit, shtetet anëtare duhet të sigurojnë koordinimin me qëllimin e nxjerrjes/përgatitjes së një plani menaxhimi për basenin lumor. Në rastet kur një plan i tillë për menaxhimin e basenit të lumit ndërkombëtar nuk realizohet, shtetet anëtare duhet të prodhojnë plane menaxhimi për basenet lumore, duke mbuluar taksën për ato pjesë të rrjetit të basenit të lumit ndërkombëtar që shtrihen në territoret e tyre, për të arritur objektivat e kësaj Direktive.</p> <p>3. Në rastin e një rrethi të basenit ndërkombëtar të një</p>		Neni 174	<p>1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është përgjegjëse për përgatitjen e PMBL-ve të para në përputhje me këtë ligj, në bazë të të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit të disponueshëm.</p> <p>2. Në rast se nuk ka të dhëna, informacione dhe dokumentacion, apo sigurimi i tyre është i pamundur për shkak të kushteve të arsyeshme, në planin e menaxhimit të baseneve lumore për rajonet e baseneve lumore përfshihet edhe shpjegimi i arsyetuar, ku të tregohet në mënyrë të veçantë se si këto të dhëna, informacione dhe dokumentacione do të ofrohen në rishikimin e parë të PMBL-së dhe si do të përfshihen më pas në të, në përputhje me pikën 6 të nenit 53 të këtij ligji.</p>	I plotë	Dispozitat proceduriale për hartimin, miratimin dhe botimin e planit të parë në përputhje me nenin 53 të ligjit “për burimet ujore”

	<p>lumi që shtrihet përtej kufijve të Komunitetit, shtetet anëtare duhet të përpiqen që të përgatisin një plan të vetëm menaxhimi për basenin ndërkombëtar të lumit dhe, në rastet kur një gjë e tillë nuk është e mundur, plani të paktën duhet të mbulojë pjesën e rrethit të basenit ndërkombëtar të lumit që shtrihet në territorin e shteteve anëtare.</p> <p>4. Plani i menaxhimit të basenit lumor duhet të përfshijë informacionin e dhënë në mënyrë të detajuar në Shtojcën VII.</p> <p>5. Planet e menaxhimit të basenit lumor mund të plotësohen me programe më të detajuara dhe plane menaxhimi për nënbasenin, sektorin, çështjen ose llojin e ujit, për të trajtuar aspekte të veçanta të menaxhimit të ujit. Zbatimi i këtyre masave nuk do t'i përjashtojë shtetet anëtare nga asnjë detyrim i tyre i parashikuar nga pjesa tjetër e kësaj Direktive.</p> <p>6. Planet e menaxhimit të baseneve lumore duhet të botohen jo më vonë se nëntë</p>					
--	---	--	--	--	--	--

	<p>vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Direktive.</p> <p>7. Planet e menaxhimit të baseneve lumore do të rishikohen dhe të përditësohen jo më vonë se 15 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive dhe do të rishikohen dhe përditësohen një herë në gjashtë vjet, pas asaj kohe.</p>					
<p>Shtojca V, pika 1 dhe pika 2</p>	<p>1.Ujërat sipërfaqësorë 2.Ujërat nëntokësorë</p>		<p>Neni 175</p>	<p>1. Për të vënë në funksion programet e monitorimit të përmendura në nenin 41 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton programin pilot të monitorimit për një prej Rajoneve të Baseneve Lumore, brenda 18 muajsh nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji. 2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton programin pilot të monitorimit të statusit të ujërave të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 2 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji. 3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për monitorimin e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë si dhe për zonat e mbrojtura, harton planin vjetor të zbatimit të programit pilot të monitorimit, brenda 2 muajsh nga miratimi i</p>	<p>I plotë</p>	<p>Aspektet procedurale për hartimin dhe zbatimin e programit pilot të monitorimit janë në përputhje me nenin 41</p>

				<p>programit pilot sipas pikës 2 të këtij neni.</p> <p>4. Plani vjetor i zbatimit të programit pilot të monitorimit për statusin e ujërave përfshihet në Programin Vjetor Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit të vitit pasardhës.</p> <p>5. Në bazë të rezultateve praktike dhe përvojës së fituar gjatë periudhës së zbatimit të programit pilot të monitorimit, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, harton programin e përgjithshëm të monitorimit për të gjithë rajonet e baseneve lumorë.</p>		
--	--	--	--	--	--	--